



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 16.5.2022, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit "Për vreshtarinë dhe verën".

#### **Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Pranvera Resulaj, Benet Beci, Agron Shehi dhe Dashamir Shehi.

#### **Mungojnë:**

Sorina Koti, Anila Denaj, Jorida Tabaku, Alfred Rushaj dhe Agron Shehaj.

#### **Të ftuar:**

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Alban Mësonjësi – Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Julinda Bare - Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë në Ministrinë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Gentian Opre - Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Eduard Shalsi** – Mirëmëngjesi!

Përhëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Para se të fillojmë mbledhjen, verifikojmë kuorumin.

Kuorumi është i pranishëm.

Thërrisni median!

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Në seancën e ditës së sotme kemi shqyrtimin nen për nen të projektligjit "Për vreshtarinë dhe verën". Relatore është zonja Pranvera Resulaj.

Për këtë çështje nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kemi ftuar zotin Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë, zotin Alban Mësonjesi, drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, zonjën Julinda Bare, përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, si dhe zotin Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor.

Ju uroj mirëseardhjen në komision!

Shqyrtimin në parim e kemi ezauruar, por përpara se të kalojmë në miratimin nen për nen ka disa rekomandime për komisionin përgjegjës për nenet 2, 4, 7, 8, 9 dhe 45, për të cilat ftoj relatoren të bëjë një koment.

Por, përpara së relatorja të bëjë komentet, dua të pyes deputetët: a kanë ndonjë gjë për të shtuar, për të pyetur, apo kërkojnë ndonjë më shumë? Nuk kanë.

Atëherë, zonja Resulaj, fjala për ju.

Kishit diçka, zoti Sinaj?

**Vullnet Sinaj** – Megjithëse nuk kam qenë në mbledhjen e parë, e gjithë fryma e projektligjit është për t'i dhënë rëndësi prodhimit të verërave në vend nga rrushi autokton. Deri sot ka pasur import të rrushit nga vendet fqinje për prodhimin e verës. A do të lejohet në të ardhmen, apo jo, importi i rrushit për prodhim vere? Në rast se do të lejohet, çfarë vere do të cilësohet ajo?

Faleminderit!

**Julinda Bare** – Sipas këtij ligji, ne nuk e lejojmë përzierjen e verërave me rrush importi, është e përcaktuar në nenin 14, pika 6.

**Eduard Shalsi** – Zonja Resulaj.

**Pranvera Resulaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Janë disa nene që i propozohen Komisionit përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese për të marrë në konsideratë ndryshimet dhe këto i janë bërë të ditura edhe ministrisë suaj.

Po filloj me propozimet për nenin 2, që kanë lidhje me përkufizimet. Ne propozojmë që të shtohen përkufizimet e disa termave, të cilat gjejnë vend në tekstin e projektligjit, por nuk gjejnë vend te përkufizimet, si: termat “kadastra e vreshtave”, përkufizimi i termit “kupazhinë” dhe përkufizimi i termit “zona të prodhimit të rrushit”, gjithashtu edhe terma të tjerë, që duhet të përfshihen te pjesa e përkufizimeve.

Gjithashtu propozohen disa ndryshime për sa i përket nenit 4 të institucioneve përgjegjëse, në të cilat propozohet që si fillim të listohen institucionet përgjegjëse, pastaj të renditen funksionet e tyre.

Ky është propozimi ynë, pra përcaktimi i institucioneve pastaj detyrat e tyre.

Kalojmë te propozimet e nenit 7 për sa u përket pasaktësive në disa terma, si, për shembull, “përcaktohet laborator” pastaj i referohet laboratorit si i autorizuar dhe i akredituar. Termi “përcaktim” nuk është një akt ligjor, kështu që do të kërkonim të kishit një zgjedhje midis termit “autorizim” dhe “akreditim”, për t’iu referuar nenit 7.

Rekomandimi që japim për nenin 8 është riformulimi në aspektet e teknikës legjislative, që të nxjerrë qartë natyrën e këshillit, si dhe të përcaktojë qartë se çfarë do të miratojë Këshilli i Ministrave në aktin nënligjor të përcaktuar sipas nenit 4. “Kriteret për anëtarët e këshillit nuk mund të jenë pjesë e këtij akti përderisa përbërja e këshillit përcaktohet nga ligji dhe anëtarët do të jenë përfaqësues të institucioneve”. Bëhet fjalë për Këshillin Kombëtar të Vitivinikulturës, për saktësi të komisionit.

Ndryshimet që propozojmë në nenin 9 ose rekomandimet që japim për sa i përket komisionit përgjegjës, lidhen me ndryshimet në aspektet e teknikës legjislative. Ne propozojmë që të kemi një saktësim të funksioneve të këshillit, duke qartësuar se kë këshillon dhe informon ky këshill kombëtar dhe kujt ia propozon ndryshimet ligjore, sepse nëse i referohemi nenit 9, aty thuhet që funksionet e Këshillit Kombëtar të Vitivinikulturës janë të përcaktuar, por propozon

kujt i propozohet dhe cilat janë këshillat, pra kë këshillon dhe informon dhe kujt ia propozon ndryshimet në rast se do të ketë.

Ne rekomandojmë që këto të saktësohen në nenin 9.

Neni 45 ka të bëjë me kundërvajtjen administrative dhe ekzekutimin e masave të marra për kundërvajtje administrative. Ne rekomandojmë që në nenet 45 dhe 46, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, të saktësohet mënyra e shqyrtimit nga komisioni i shqyrtimit të masave administrative në institucionin e kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Pra, shkurt, të saktësohet legjislacioni të cilit i referohen këto masa administrative.

Këto janë kryesisht ndryshimet nen pas neni që kemi propozuar.

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Nëse ministria nuk ka komente, ne kalojmë në miratimin nen për nen të projektligjit dhe t'ia sugjerojmë Komisionit përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

**Alban Mësonjesi** – Ne kemi komunikuar me shërbimet, kemi kthyer argumentet tona, jemi dakord dhe mund të vijohet me miratimin.

**Eduard Shalsi** – Pa humbur kohë, vijojmë me miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2, gjithmonë sipas rekomandimit që u paraqit. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4, gjithmonë sipas rekomandimit që u paraqit. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7, me rekomandimin për komisionin përgjegjës. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8, gjithashtu sipas rekomandimit të cituar nga relatorja për komisionin përgjegjës. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9, po ashtu sipas rekomandimeve për komisionin përgjegjës. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 22. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 23. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 24. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 25. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 26. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 27. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 28. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 29. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 30. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 31. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 32. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 33. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 34. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 35. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 36. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 38. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 39. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 40. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 41. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 42. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 43. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 44. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 45, sipas rekomandimeve për komisionin përgjegjës. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 46. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 47. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 48. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

**Vullnet Sinaj** – Te neni 48, pika 1, thuhet: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave për të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pikat 3 dhe 4, nenit 19, pika 5, neni 31 pika 2...” e me radhë dhe thotë brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit. Në nenin 10 kemi një detyrë për Këshillin e Ministrave, i cili ngarkohet të caktojë zonat që do të jenë për mbjelljen e rrushit. A

mund të ketë këtu një afat për nxjerrjen e akteve nënligjore se kur do të dalin këto zona, se nuk ka asnjë afat. Ja ta kaloj te nen 10 që t'jua lexoj.

Neni 10, pika 6, pika e fundit: “Përcaktimi i zonave të prodhimit të rrushit për verë të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave pas përfundimit dhe miratimit të studimit nga ministri për zonat e kultivimit të vreshtave për verë”. A do të ketë një afat caktimi i zonave të...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të kemi një afat për këtë pastaj të merremi me ata.

Ku e ka të shkruar neni 48?

**Eduard Shalsi** – Ndize mikrofonin.

**Alban Mësonjesi**– Këshilli i Ministrave ka detyrimin ta miratojë VKM-në brenda dy vjetëve, edhe VKM-ja e nenit 10 është parashikuar të miratohet për dy vite. Mund ta saktësojmë, ta shtojmë dhe nenin 10.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zoti Spaho, më pas zoti Shehu.

**Edmond Spaho** - Le të themi që ju po e bëni gjithë këtë përpjekje për të nxitur prodhimin e verës nga rrushi vendas dhe, sikurse tha edhe zonja më parë, nuk do të lejoni përdorimin e rrushit të importit në prodhimin e verës vendase. Si do të kontrollohet kjo përzierje me ato dhjetëra kantina që janë në Shqipëri? Aty duhet të mbash polic me tre turne.

**Dashamir Shehu** - ...që u jepte një subvencion për vreshtat, sot nuk ka më. Vjet kishte? Ky ligji që keni bërë është shumë i mirë, unë nuk kam ndonjë ekspertizë për këtë punë, sepse mua më duket shumë i ngatërruar, por inshallah do të respektohet, por ne po themi të nxitet pak prodhimi vendas, kjo është kryesorja. Besoj ne kemi numrin më të vogël të sipërfaqeve të vreshtës për hektarë, po e quaj të punueshme, pra jemi mbrapa të gjitha vendeve, Maqedonisë, që është më thellë se ne, se të gjitha vendeve të Mesdheut mbjellin më shumë në raport me sipërfaqet. A ka ndonjë politikë që të rritet prodhimi lokal, të rriten sipërfaqet e mbjella? Ndoshta nuk është subjekt i këtij ligji, mund të jetë i një tjetri, por them meqë ky ligjin i mëshon kaq shumë çështjes së verës e të rrushit të vihej diçka për këtë punë, se do të ishte e rëndësishme. Nëse nuk mbillen vreshta atëherë bëjmë ligje kot. Ne e patëm subvencionin dhe e hoqëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sigurisht, nëse nuk shtohen sipërfaqet këto janë muhabete kot, vetëm për ta bërë lineare me Europën këtë ligj se nuk besoj se ka vlerë tjetër këtu me kaq pak hektarë që kemi. Më shumë



ka faqe ligji se sa ka hektarë me rrush. Kjo është bërë për të qenë në linjë me legjislacionin europian.

**Alban Mësonjesi** – Financimet nuk janë objekt i këtij ligji. Ligji “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” krijon mundësinë e financimeve, janë dhënë financime vit pas viti, aktualisht financon IPARD-i, por këtë vit nga skemat kombëtare vreshtaria nuk ka pasur mbështetje, mbështetje do të ketë, por nuk është e nevojshme të futet në këtë ligj. Ky ligj ka një objekt tjetër aktiviteti.

Për t’i dhënë përgjigje zotit Spaho, ligji në tërësinë e vet krijon institucione, që do të kontrollojnë, do të kemi regjistrin e vreshtave. Pra, ne do ta kemi të ditur sa prodhim mund të ketë dhe çfarë prodhimi mund të ketë, pra do të jetë regjistri i hyrje-daljeve, ka një sërë aktesh dhe institucionesh, që do të kontrollojnë sa kapacitet prodhimi ka dhe sa do të prodhohet. Në tërësinë e vet institucionet dhe kompetencat çojnë drejt kontrollit.

Faleminderit!

**Edmond Spaho** – Nëse unë dëshiroj të prodhoj verë, se kam një kantinë, dhe e marr të gjithë rrushin nga importi, mua më lejohet, apo jo? Përzierja nuk lejohet. Atëherë, pse nuk ia lini tregut cilësinë e verës që të bëjë këtë mekanizmin, se nuk besoj se me mënyrat administrative do të arrini ta pengoni përzierjen? Sot të gjitha përzihen, çfarë prodhohet në Shqipëri është e përzierë dhe kështu ka për të vazhduar dhe do të jetë shumë e vështirë për ju ta kontrolloni. Atë e kontrollon tregu, po pati verë të mirë e prodhuar nga rrush vendi, me ato varietetet, që janë të njohura te ne, do të shitet, madje me një çmim më të lartë, nëse nuk do të jetë cilësi e mirë do t’ia kthejë vetë tregu konsumatorit. Kështu gjykoj unë.

**Eduard Shalsi** – A keni koment të fundit për të bërë?

Atëherë, neni 48 me sugjerimin e zotit Sinaj miratohet.

Neni 49. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 50. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 51. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është pro projektligjit në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi.

Me këtë ligj mbyllim rendin e ditës për ditën e sotme.

Nesër në orën 10 kemi lënë mbledhjen për diskutimin nen për nen të marrëveshjes së Butrintit, ndërkohë në orën 8:30 një grup studentësh, nuk e di sa janë, kanë kërkuar një takim me komisionin, prania nuk është e detyrueshme, dëgjuesat janë të tipit formal dhe joformal. Studentët kanë shprehur vetë dëshirën nisur nga debati, kanë nxjerrë çfarë është thënë në televizione, kush ka thënë çfarë dhe në dijeninë time kanë bërë një studim krahasimor me planet e zhvillimit të Butrintit 2000, 2005, 2007, 2012 dhe 2020.

Unë mendoj që zoti Spaho dhe zoti Leskaj bënë humor duke thënë çfarë është kjo eksperiencë me studentët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë e mora si formë humori, por të jeni të kujdesshëm kur flisni për studentët!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho, unë di të them një gjë: ke qenë student vetë, të gjithë kemi qenë studentë, ata që përdoren, përdoren, ata që nuk duan të përdoren, kanë kurajë shumë të fortë.

Dakord?

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretare e Komisionit**  
**Enslmvera Zake**

**Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar administrativ**  
**Elvi Prifti**